

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.10/12/2024 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

SUSANNE ELISABETH CAPPEL, shtetase gjermane , e datelindjes 10/06/1964, e lindur ne Gjermani ne FRANKENBERG (EDER) dhe banuese ne Königswintererstraße 527 53227 Bonn , madhore, me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes gjermane me Nr. **C79VVX42V**, leshuar ne date 13/01/2023,
ROBERTO PEDRO LOHSE SOTO , shtetas gjerman , i datelindjes 15/11/1959, i lindur ne RECOLETA, Chile dhe banues ne Königswintererstraße 527 53227 Bonn , madhor, me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes gjermane me Nr. **C79863C6X**, leshuar ne date 08/11/2019,
te cilet me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **Vjosa-Touristik** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **Vjosa-Touristik** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").
Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.
Shoqëria **Vjosa-Touristik** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

-Permet, Kaludh, Rruga Nationale Tre Urrat , godina nr.1

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojne filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shitje dhe blerje, dhenie me qera, administrim te pasurive te paluajtshme si ndertesa, toka, troje .

Neni 5

Kohezgjatia

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te ppercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: , **SUSANNE ELISABETH CAPPEL** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 5,000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **ROBERTO PEDRO LOHSE SOTO** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 5,000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per geshtje te tjera si: emerimin dhe shkarkimin e administratoreve, te likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, percaktimin e shperblimeve, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.

Gdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i cili do të jetë **SUSANNE ELISABETH CAPPEL**, shtetase gjermane, e datelindjes 10/06/1964, e lindur në Gjermani në FRANKENBERG (EDER) dhe banuese në Königswintererstraße 527 53227 Bonn, madhore, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet pasaportës gjermane me Nr. **C79VVX42V**, leshuar në datë 13/01/2023, Emerimi i administratorit është me një afat pesë vjeçar me të drejtë rimerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar së bashku në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Administratori/et angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori/et ose ortakët që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jehet

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto rast Asambleja e ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këto akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligji për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën nën nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare **Vjosa-Touristik** shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISE

SUSANNE ELISABETH CAPPEL

ROBERTO PEDRO LOHSE SOTO

Susanne Cappel

Roberto Pedro Lohse Soto

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'S' followed by a large, circular flourish that encloses the letters 'Cappel'.A handwritten signature in blue ink, featuring a large, bold 'R' followed by 'oberto Pedro Lohse Soto' in a cursive script.